

Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo			
Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës			
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova			
Civil Aviation Authority of Kosovo			
CAA			
Nr. i prot.	2022/20P/367		
Br. prot./Prot. Nr.			
Faqe: 5+5	Kopje: -	Datë: 30.11.2022	
Stranica/Pages	Kopija/Copy	Datum/Date	
Hyrës/ulazno/in	☐		
Dalës/izlazo/out	☒		
Brendshëm/interio/internal	☐		
Prishtinë/Prishtina/Pristina			

Datë/Datum/Date:	30.11.2022
Për/Za/To:	Z. Arben Krasniqi , Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Qeveria e Republikës së Kosovës
Nga/Od/From:	Z. Bujar Ejupi , Drejtor i Përgjithshëm, Autoriteti i Aviacionit Civil i Republikës së Kosovës
Lënda/Subjekat/Subject:	Plani i Performancës i Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2023

Me hyrjen në fuqi të Ligji nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura përmes të cilit ka pësuar ndryshime edhe Ligji për AAC-në, tani Autoriteti i Aviacionit Civil ka statusin e Agjencisë rregullatore në pajtim me Ligjin përkatës për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, ku mbikëqyrja e performancës dhe veprimtarisë së AAC-se është përgjegjësi e Qeverisë së Kosovës e cila ushtrohet nëpërmjet Ministrit përgjegjës për transport.

AAC është e ngarkuar me rregullimin e aspekteve të sigurisë së aviacionit civil dhe rregullimin ekonomik të aeroporteve dhe ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror. Rregullimi ekonomik i aeroporteve dhe ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror nënkupton miratimin e tarifave për shfrytëzimin e shërbimeve që ofrojnë këta operatorë.

AAC është organizatë me të hyra buxhetore dhe autoritet publik dhe iu nënshtrohet dispozitave përkatëse mbi organizatat buxhetore dhe autoritetet publike në ligjet dhe aktet e tjera nënligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës.

AAC ka hartuar dhe miratuar Objektivat Strategjike për periudhën 2019-2023. Plani i punës në AAC është i bazuar në objektivat strategjike të AAC-së, zbërthen ato në objektiva operative dhe në veprime të detajuara që rrjedhimisht rezultojnë në pesë dokumente të brendshme që përcillen për realizimin e tyre në çdo tremujor nga menaxhmenti i AAC-së.

PLANI I PERFORMANCËS I AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL TË KOSOVËS 2023

PËRGJEGJËSITË E AAC-së

Autoriteti i Aviacionit Civil i Republikës së Kosovës (AAC) është themeluar si agjenci e pavarur rregullatore në bazë të Nenit 14 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil. Që nga 1 janari 2009, AAC-ja ka marrë kompetencat e plota në përputhje me këtë ligj. AAC-ja është njëra nga autoritetet publike me përgjegjësi dhe funksione në fushën e aviacionit civil në vendin tonë.

AAC-ja është e ngarkuar me rregullimin e aspekteve të sigurisë së aviacionit civil dhe rregullimin ekonomik të aeroporteve dhe ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror. Rregullimi ekonomik i aeroporteve dhe ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror nënkupton miratimin e tarifave për shfrytëzimin e shërbimeve që ofrojnë këta operatorë. AAC-ja ka kapacitet të plotë juridik dhe për performancën dhe veprimtarinë e saj i përgjegjet Qeverisë së Kosovës, nëpërmjet Ministrit përgjegjës për transport.

AAC-ja është përgjegjëse për:

- a) Zbatimin e legjislacionit mbi aviacionin civil dhe zbatimin e politikave të miratuara nga Ministria ose Qeveria në fushën e Aviacionit Civil;
- b) Ofrimin e këshillave dhe propozimeve për Ministrinë, Qeverinë dhe Kuvendin lidhur me politikën dhe legjislacionin nga fusha e Aviacionit Civil;
- c) Nxjerrjen e rregullave të zbatimit dhe urdhërave për siguri të navigimit ajror, në përputhje me Ligjin bazik dhe Marrëveshjen HPEA, me qëllim të zbatimit të politikave të Aviacionit Civil të Ministrisë dhe legjislacionit përkatës nga fusha e Aviacionit Civil;
- d) Lëshimin e Licencave, Certifikatave dhe Lejeve në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë e AAC-së;
- e) Rregullimin e sigurisë së transportit ajror në Republikën e Kosovës;
- f) Rregullimin ekonomik të tregut të aeroporteve dhe shërbimeve të navigimit ajror;
- g) Ofrimin e këshillave për Ministrinë në lidhje me përgatitjen e propozim-politikave mbi shfrytëzimin e hapësirës ajrore të Kosovës të cilat i përmbushin nevojat e shfrytëzuesve, duke pasur parasysh sigurinë kombëtare, faktorët ekonomik dhe mjedisor, nevojën për standarde të larta të sigurisë;
- h) Mbikëqyrjen dhe sigurimin e zbatimit në mënyrë efektive të legjislacionit, standardeve, rregullave, procedurave dhe urdhërave të aviacionit civil, përveç, kur me Ligjin bazik ose me një Akt tjetër juridik, ky funksion shprehimisht i është dhënë Ministrisë ose një autoriteti tjetër publik;
- i) Shpërndarjen e informatave për publikun rreth çështjeve relevante mbi funksionet dhe aktivitetet e AAC;
- j) Në përputhje me dispozitat dhe qëllimin e Ligjit bazik, marrjen e masave, kryerjen e hetimeve, inspektimeve dhe nxjerrjen e urdhërave, rregullave, Rregulloreve dhe/ose procedurave të cilat AAC me arsye i konsideron të nevojshme për: (i) zbatimin e rregullt dhe të ligjshëm të dispozitave të Ligjit bazik ose (ii) ushtrimin e rregullt dhe të ligjshëm të kompetencave dhe detyrave të cilat i janë dhënë AAC me Ligjin bazik;
- k) Ushtrimin e funksioneve të tjera të cilat kanë të bëjnë me Aviacionin Civil në Kosovë, që janë dhënë sipas Ligjit bazik ose legjislacionit tjetër në fuqi.

OBJEKTIVAT E AAC-së PËR VITIN 2023

1. Plotësimi i legjislacionit sekondar

Plotësimi i legjislacionit sekondar përmes zbatimit të kërkesave të përbashkëta të aviacionit që rrjedhin nga Marrëveshja për Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit (HPEA), përfshirë:

- Transpozimin e Acquis-së së BE-së në fushën e aviacionit;
- Përvetësimin e Standardeve dhe Praktikave të Rekomanduara të përditësuara nga ICAO;
- Hartimin e akteve tjera nënligjore të aviacionit për zbatimin e Ligjit për Aviacionin Civil, bazuar në specifikat e vendit;
- Nxjerrjen e Urdhërave dhe Udhëzimeve Administrative për zbatimin e Rregulloreve; dhe
- Nxjerrjen e Vendimeve Ekzekutive për zbatimin e specifikave të certifikimit dhe e mjeteve tjera të pranueshme të pajtueshmërisë.

2. Certifikimi i operatorëve, licencimi i personelit dhe mbikëqyrja e vazhdueshme

2.1 Certifikimi i operatorëve të aviacionit

2.2 Licencimi i personelit të aviacionit (licencimi i kontrollorëve dhe paragllajdistëve, lëshimi i certifikatave mjekësore, etj.)

2.3 Lëshimi i lejeve për fluturimet VFR dhe ato diplomatike, për mallrat e rrezikshme, për operimet me sisteme të mjeteve ajrore pa pilot (dronë)

2.4 Aprovimi i fluturimeve për mjetet e huaja ajrore civile

2.5 Regjistrimi i operatorë të sistemeve të mjeteve ajrore pa pilot (SAP/dronëve) dhe nxjerra e vendimeve për operimet e paautorizuara me këto sisteme

2.6 **Mbikëqyrja e vazhdueshme e operatorëve dhe mbikëqyrja e brendshme:**

2.6.1 Auditimet/inspektimet e sigurisë në fushën e shërbimeve të navigacionit ajror (operatori ASHNA)

2.6.2 Auditimet/inspektimet e sigurisë në fushën e aerodromeve (operatori ANP "Adem Jashari" LKIA):

- a) Auditimet/inspektimet e sigurisë të shërbyesve në tokë;
- b) Auditimet/inspektimet e organizatave trajnuese në fushën e aerodromeve dhe ofruesve të shërbimeve në tokë;
- c) Implementimi i Rregullores për shenjëzimin e pengesave (veçanërisht inspektimi dhe identifikimi i largpërçuesve që kalojnë mbi autoudha); dhe
- d) Vlerësimet aeronautike për ndërtimet brenda zonave mbrojtëse të aerodromeve, si dhe objekteve të larta në territorin e Republikës së Kosovës (veçanërisht të turbinave të erës).

2.6.3 Auditimet/inspektimet në fushën e sigurisë së fluturimeve (operimet ajrore, vlefshmëria ajrore dhe licencimi i personelit):

- a) Auditimi/inspektimi i Organizatave të Aprovuara Trajnuese (ATO);
- b) Auditimi/inspektimi i organizatave të certifikuara për trajtimin e mallrave të rrezikshme (DGR);

- c) Auditimi/inspektimi i organizatave trajnuese të certifikuara për mallrat e rrezikshme (DGR);
- d) Auditimet/inspektimet në fushën e Aviacionit të Përgjithshëm (GAT);
- e) Auditimet/inspektimet në fushën e Mjekësisë së Aviacionit (MED); dhe
- f) Inspektimet në platformë (SAFA) të mjeteve ajrore të operatorëve të huaj.

2.6.4 Auditimet e brendshme të Sistemit të Menaxhimit të AAC-së (Sistemit për Menaxhimin e Cilësisë dhe Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë, përfshirë Programin Shtetëror të Sigurisë (PShS)):

Përmes PShS-së, kërkohet hartimi dhe zbatimi i një programi të përbashkët, i cili definon qartë strukturën dhe hierarkinë shtetërore të përgjegjësive në sigurinë e aviacionit civil, definon rolet e hisedarëve dhe koordinimin e punëve në mes tyre. Ky program i definon gjithashtu politikat e shtetit për sigurinë dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi.

2.7 Mbikëqyrja ekonomike e operatorëve të aviacionit (ASHNA-s, ANP “Adem Jashari” LKIA dhe shërbyesve në tokë):

2.7.1 Certifikimi/licencimi/aprovimi i operatorëve të aviacionit; dhe

2.7.2 Miratimi i tarifave të rregulluara aeronautike.

2.8 Menaxhimi i sistemit të raportimit të ndodhjeve në aviacion (trajtimi/ hetimi i ndodhjeve, futja e tyre në formatin/bazën e të dhënave në ECCAIRS)

3. Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe ndërinstytucional dhe normalizimi i hapësirës ajrore

3.1 Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare:

3.1.1 Anëtarësimi në ICAO:

Është objektiv strategjik i AAC-së realizimi i anëtarësimit të Kosovës në Organizatën Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO) për shkak të rëndësisë së jashtëzakonshme të këtij anëtarësimi. Do t'i ipet përkrahje teknike MPJD-së në procesin e aplikimit për anëtarësim në ICAO, përfshirë draftimin e instrumenteve formale të aderimit.

3.1.2 Anëtarësimi në ECAC dhe EUROCONTROL:

Anëtarësimi në ICAO do të hapë rrugën për anëtarësim në Konferencën Evropiane të Aviacionit Civil (ECAC) dhe Organizatën Evropiane për Siguri të Navigacionit Ajror (EUROCONTROL). Do t'i ipet përkrahje teknike MPJD-së në procesin e aplikimit për anëtarësim.

3.2 Lidhja e marrëveshjeve teknike ndërkombëtare dhe rajonale:

Lidhja e marrëveshjeve për bashkëpunim me autoritetet e aviacionit civil në Evropë dhe më gjerë, si dhe vazhdimi i përpjekjeve për të lidhur aranzhime pune me EASA-n.

3.3 Aranzhimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me autoritet shtetërore për mbrojtjen e mjedisit

3.4 Implementimi i Projektit të Bashkëpunimit Teknik të EASA-s, EASA IPA-6

Koordinimi dhe pjesëmarrja në aktivitetet përmbyllëse të Projektit EASA IPA-5 dhe realizimi i aktivitetëve të edicionit të ardhshëm të Projektit, EASA IPA-6.

3.5 Normalizimi i hapësirës ajrore:

Hapësira e lartë ajrore e Republikës së Kosovës e cila përdoret për mbikalime të aeroplanëve civil është e deleguar përkohësisht nga NATO, në pajtim me institucionet e Kosovës, të HungaroControl, gjegjësisht Hungaria. Ndërsa hapësira e ulët ajrore kontrollohet nga ASHNA, dhe në këtë hapësirë përdoren vetëm dy korridore për trafik komercial, për hyrje dhe dalje nga territori i Kosovës, të cilat ndodhen në kufi me Maqedoninë e Veriut. Për një operim plotësisht funksional në territorin e Republikës së Kosovës, përveç normalizimit të plotë të hapësirës së ulët ajrore për aviacionin e përgjithshëm, shfrytëzimi i plotë i hapësirës është element thelbësor, prandaj AAC-ja do ta përkrahë ASHNA-n në përgatitjen për:

3.5.1 Menaxhimin e hapësirës së lartë ajrore;

3.5.2 Hapjen e korridorit ajror në hapësirën e ulët ajrore Kosovë - Shqipëri; dhe

3.5.3 Hapjen e korridorit ajror në hapësirën e ulët ajrore Kosovë - Mali i Zi.

BUXHETI I AAC-së PËR VITIN 2023

Buxheti sipas kërkesës së Autoritetit të Aviacionit Civil dhe sipas Qarkores Buxhetore 2023/2 të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve është i paraqitur në vijim:

Kategoria	Qarkorja buxhetore 2023/02 - MFPT	Kërkesa buxhetore 2023 e AAC-së	Diferenca: Kërkesa Buxhetore 2023 - Qarkorja Buxhetore 2023/02 - MFPT
Paga dhe Meditje	768,543.00	1,028,061.00	(259,518.00)
Mallra dhe Shërbime	150,000.00	281,456.00	(131,456.00)
Shpenzime Komunale	3,738.00	3,738.00	-
Shpenzime Kapitale	-	-	-
Totali i Buxhetit	922,281.00	1,313,255.00	(390,974.00)

Datë/Datum/Date:	30.11.2022
Për/Za/To:	G. Arben Krasniqi , Zamenik Generalni sekretar, Vlada Republike Kosovo
Nga/Od/From:	G. Bujar Ejupi , Generalni direktor, Autoritet civilnog vazduhoplovstva Republike Kosovo
Lënda/Subjekat/Subject:	Plan učinka Autoriteta civilnog vazduhoplovstva za 2023. godinu

Stupanjem na snagu Zakona br. 08/L-063 za izmjene i dopune zakona koji se odnose na nacionalizaciju i uspostavu linija odgovornosti neovisnih agencija kroz koje je Zakon o HAA-u doživio ismjene, sada Uprava za civilno zrakoplovstvo ima status regulatorne agencije u skladu sa relevantnim Zakonom o organizaciji i daju državne uprave i nezavisnih agencija, dge je nadzor nad učinkom i aktivnostima ACV-a odgovornost Vlade Kosova, koja se vrši preko ministra odgovornog za transport.

ACV je zadužena regulisanjem aspekata bezbednosti civilnog vazduhoplovstva i ekonomskim regulisanjem aerodroma i pružaoca usluga vazdušne navigacije. Ekonomsko regulisanje aerodroma i pružaoca usluga vazdušne navigacije podrazumeva usvajanje tarifa za korišćenje usluga kojih pružaju ovi operateri. ACV je samofinansirajuća budžetska organizacija i javni autoritet i podleže relevantnim odredbama o budžetskim organizacijama i javnim autoritetima u zakonima i ostalim podzakonskim aktima primenjivim u Republici Kosovo.

ACV je izradio i usvojio Strateške ciljeve za period od 2019-2023. godine. Plan rada u ACV-u je zasnovan na strateškim ciljevima ACV-a, razlaže ih na operative ciljeve i na detaljne aktivnosti koje posledično rezultiraju sa pet internih dokumenata kojih rukovodstvo ACV-a svakog tromesečja prosleđuje za njihovu dalju realizaciju.

PLAN UČINKA AUTORITETA CIVILNOG VAZDUHOPLOVSTVA KOSOVA ZA 2023. GODINU

ODGOVORNOSTI ACV-a

Autoritet civilnog vazduhoplovstva Republike Kosovo (ACV) je osnovan kao nezavisna regulatorna agencija na osnovu člana 14. Zakona br. 03/L-051 o civilnom vazduhoplovstvu. Od 1. januara 2009. godine, ACV je dobio pune nadležnosti u skladu sa ovim zakonom. ACV je jedan od državnih organa sa odgovornostima i funkcijama u oblasti civilnog vazduhoplovstva u našoj zemlji.

ACV je zadužen za regulisanje aspekata bezbednosti civilnog vazduhoplovstva i ekonomsko regulisanje aerodroma i pružalaca usluga vazdušne navigacije. Ekonomska regulacija aerodroma i pružalaca usluga vazdušne navigacije podrazumeva odobravanje tarifa za korišćenje usluga koje ovi operateri pružaju. ACV ima puni pravni kapacitet i za svoj za svoj učinak i rad odgovara Vladi Kosova, preko Ministra nadležnog za saobraćaj.

ACV je odgovoran za:

- a) sprovođenje zakonodavstva o civilnom vazduhoplovstvu i sprovođenje politika koje usvaja ministarstvo ili Vlada iz oblasti civilnog vazduhoplovstva;
- b) pružanje saveta i predloga ministarstvu, Vladi i Skupštini o politikama i zakonodavstvu iz oblasti civilnog vazduhoplovstva;
- c) donošenje propisa o sprovođenju i naredbama za bezbednost vazduhoplovne navigacije, u skladu sa osnovnim zakonom i Sporazumom ZEVP (ECAA), u cilju sprovođenja politika civilnog vazduhoplovstva ministarstva i relevantnog zakonodavstva iz oblasti civilnog vazduhoplovstva;
- d) izdavanje licenci, sertifikata i dozvola u skladu sa nadležnostima i odgovornostima ACV-a;
- e) regulisanje bezbednosti vazdušnog saobraćaja u Republici Kosovo;
- f) ekonomsko regulisanje tržišta aerodroma i usluga vazduhoplovnih navigacija;
- g) pružanje saveta ministarstvu u pogledu pripreme predlog-politika za korišćenje vazdušnog prostora Kosova koje ispunjavaju potrebe korisnika, imajući u obzir nacionalnu bezbednost, ekonomske i ekološke faktore, te potrebu za visokim standardima bezbednosti;
- h) nadgledanje i obezbeđivanje efektivne primene zakonodavstva, standarda, pravila, postupaka i naredbi civilnog vazduhoplovstva, osim ako je osnovnim zakonom ili drugim pravnim aktom ova funkcija izričito data ministarstvu ili drugom javnom autoritetu;
- i) prosleđivanje informacija javnosti u pogledu relevantnih pitanja o funkcijama i aktivnostima ACV-a;
- j) u skladu sa odredbama i ciljem osnovnog zakona, preduzimanje mera, vođenje istraga, inspeksijskog nadzora i donošenje naredbi, pravila, Uredaba i/ili postupaka koje ACV opravdano smatra neophodnim radi (i) redovnog i zakonskog sprovođenja odredaba ovog zakona ili (ii) redovnog i zakonitog vršenja ovlašćenja i dužnosti koje su date ACV-u osnovnim zakonom;
- k) obavljanje drugih funkcija koje se odnose na civilno vazduhoplovstvo na Kosovu, koje su istom date prema osnovnom zakonu ili drugim važećim zakonodavstvom.

CILJEVI ACV-a ZA 2023. GODINU

1. Kompletiranje podzakonskih akata

Dopuna podzakonskih akata kroz implementaciju zajedničkih vazduhoplovnih zahteva koji proizilaze iz Sporazuma o Zajedničkom evropskom vazдушnom prostoru (Z EVP), uključujući:

- Transpozicija acquis-a EU u oblasti vazduhoplovstva;
- Sticanje Standarda i Preporučenih praksi koje ažurira ICAO;
- Izrada drugih podzakonskih akata vazduhoplovstva za sprovođenje Zakona o civilnom vazduhoplovstvu, na osnovu specifičnosti zemlje;
- Izdavanje naredbi i Administrativnih uputstava za sprovođenje propisa; i
- Donošenje Izvršnih odluka za implementaciju sertifikacionih specifikacija i drugih prihvatljivih sredstava za usaglašenost.

2. Sertifikacija operatera, licenciranje osoblja i stalni nadzor

2.1 Sertifikacija vazduhoplovnih operatera

2.2 Licenciranje vazduhoplovnog osoblja (licenciranje kontrolora i paraglajdera, izdavanje lekarskih uverenja, itd.)

2.3 Izdavanje dozvola za VFR i diplomatske letove, za opasne materije, za operacije sa sistemima bespilotnih letelica (dronovi)

2.4 Odobrenje letova stranih civilnih vazduhoplova

2.5 Registracija operatera sistema bespilotnih letelica (SBL/dronovi) i donošenje rešenja za neovlašćene operacije sa ovim sistemima

2.6 Kontinuirani nadzor operatera i interni nadzor:

2.6.1 Revizije/inspekcije bezbednosti u oblasti usluga vazdušne navigacije (operater AVNU)

2.6.2 Bezbednosne revizije/inspekcije u oblasti aerodroma (operater MAP "Adem Jashari" LKIA)

- a) Bezbednosne revizije/inspekcije pružalaca zemaljskih usluga;
- b) Revizije/inspekcije organizacija za obuku u oblasti aerodroma i pružalaca zemaljskih usluga;
- c) Sprovođenje Uredbe o obeležavanju prepreka (naročito inspekcija i identifikacija daljinskih provodnika koji prolaze preko autoputeva); i
- d) Vazduhoplovne procene za konstrukcije unutar zaštitnih zona aerodroma, kao i visoke zgrade na teritoriji Republike Kosovo (posebno vetrenjača).

2.6.3 Revizije/inspekcije u oblasti bezbednosti letenja (vazdušne operacije, plovidbenost i licenciranje osoblja):

- a) Revizija/inspekcija Odobrenih organizacija za obuku (ATO);
- b) Revizija/inspekcija sertifikovanih organizacija za rukovanje opasnom robom (DGR);
- c) Revizija/inspekcija sertifikovanih organizacija za obuku opasne robe (DGR);
- d) Revizije/inspekcije u oblasti Opšteg vazduhoplovstva (GAT);

- e) Revizije/inspekcije u oblasti Vazduhoplovne medicine (MED); i
 - f) Inspekcije na platformi (SAFA) vazduhoplova stranih operatera.
- 2.6.4 Interne revizije Sistema upravljanja ACV-a (Sistem upravljanja kvalitetom i Sistem upravljanja bezbednošću, uključujući Državni program bezbednosti (DPB)):
- Kroz DPB je potrebna izrada i implementacija zajedničkog programa, koji jasno definiše državnu strukturu i hijerarhiju odgovornosti u bezbednosti civilnog vazduhoplovstva, definiše uloge akcionara i koordinaciju rada između njih. Ovaj program takođe definiše bezbednosnu politiku države i sprovođenje zakona na snazi.
- 2.7 **Ekonomski nadzor vazduhoplovnih operatera** (AVNU, MAP “Adem Jashari” LKIA i pružalaca zemaljskih usluga):
- 2.7.1 Sertifikacija/licenciranje/odobrenje vazduhoplovnih operatera; i
 - 2.7.2 Odobrenje regulisanih vazduhoplovnih tarifa.
- 2.8 **Upravljanje sistemom za izveštavanje o događajima u vazduhoplovstvu** (rukovanje/istraga događaja, njihovo unošenje u ECCAIRS format/bazu podataka)

3. Međunarodna i međuinstitucionalna saradnja i normalizacija vazdušnog prostora

3.1 Članstvo u međunarodnim organizacijama:

3.1.1 Članstvo u ICAO:

Strateški cilj ACV-a je da postigne članstvo Kosova u Međunarodnoj organizaciji civilnog vazduhoplovstva (ICAO) zbog izuzetnog značaja ovog članstva. Tehnička podrška će biti pružena Ministarstvu inostranih poslova i dijaspore (MIPD) u procesu apliciranja za članstvo u ICAO, uključujući izradu formalnih instrumenata za pristupanje.

3.1.2 Članstvo u ECAC i EUROCONTROL:

Članstvo u ICAO će otvoriti put za članstvo u Evropskoj konferenciji civilnog vazduhoplovstva (ECAC) i Evropskoj organizaciji za bezbednost vazdušne plovidbe (EUROCONTROL). Tehnička podrška biće pružena MIPD-u u procesu apliciranja za članstvo.

3.2 Sklapanje međunarodnih i regionalnih tehničkih sporazuma:

Sklapanje sporazuma o saradnji sa vlastima civilnog vazduhoplovstva u Evropi i šire, kao i nastavak napora na uspostavljanju radnih aranžmana sa EASA-om.

3.3 Dogovaranje sporazuma o saradnji sa državnim organima za zaštitu životne sredine

3.4 Implementacija EASA projekta tehničke saradnje, EASA IPA-6

Koordinacija i učešće u završnim aktivnostima EASA IPA-5 projekta i realizacija aktivnosti sledećeg izdanja projekta, EASA IPA-6.

3.5 Normalizacija vazdušnog prostora:

Viši vazdušni prostor Republike Kosovo, koji se koristi za prelete civilnih aviona, NATO, u dogovoru sa institucijama Kosova, je privremeno delegirao HungaroControl-u, odnosno Mađarskoj. Dok niži vazdušni prostor kontroliše AVNU, a u ovom prostoru se za komercijalni saobraćaj koriste samo dva koridora, za ulazak i izlazak sa teritorije Kosova, koji se nalaze na granici sa Severnom Makedonijom. Za potpuno funkcionalnu operaciju na

teritoriji Republike Kosovo, pored potpune normalizacije nižeg vazdušnog prostora za opštu avijaciju, potpuna iskorišćenost prostora je suštinski element, stoga će ACV podržati AVNU u pripremi za:

3.5.1 Upravljanje višim vazdušnim prostorom;

3.5.2 Otvaranje vazdušnog koridora u niži vazdušni prostor Kosovo - Albanija; i

3.5.3 Otvaranje vazdušnog koridora u niži vazdušni prostor Kosovo - Crna Gora.

BUDŽET ACV-a ZA 2023. GODINU

Budžet prema zahtevu Autoriteta civilnog vazduhoplovstva i prema Budžetskom cirkularu 2023/2 Ministarstva finansija, rada i transfera je predstavljen u nastavku:

Kategorija	Budžetski cirkular 2023/02 - MFRT	Zahtev za budžet ACV-a za 2023	Razlika: Zahtev za budžet 2023 - Budžetski cirkular 2023/02 - MFRT
Plate i dnevnice	768,543.00	1,028,061.00	(259,518.00)
Roba i usluge	150,000.00	281,456.00	(131,456.00)
Komunalije	3,738.00	3,738.00	-
Kapitalni rashodi	-	-	-
Ukupan budžet	922,281.00	1,313,255.00	(390,974.00)